



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 73

Tiranë – E enjte, 28 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 20.4.2016	Për miratimin e dokumentit të ndryshimit të marrëveshjes së grantit, të miratuar me vendimin nr. 636, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së grantit suedez, nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administrator i fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”.....
	4265
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 20.4.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vendimeve nr. 00-2014-1797, datë 3.6.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 1650, datë 15.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pezullimin e gjykimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor dhe zhvillimin e gjykimit incidental për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të pikës 3, të nenit 289, të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....
	4267
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 2232, datë 21.4.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit, Himarë”, i ndryshuar.....
	4279

**VENDIM****Nr. 294, datë 20.4.2016**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË
NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 636, DATË 31.7.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT SUEDEZ, NR. TF014255,
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI
ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT
TË SIGURUARA NGA SUEIDIA, E
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (SIDA),
PËR BASHKËFINANCIMIN E
PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE
DHE UJITJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës
dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë

9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe
marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin
e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i
Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të ndryshimit të
marrëveshjes së grantit, të miratuar me vendimin
nr. 636, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave,
“Për miratimin e marrëveshjes së grantit suedez
nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës
Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
(IBRD), që vepron si administrator i fondeve
grant të siguruar nga Suedia, e përfaqësuar nga
Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim
Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e
projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”, sipas
tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në
Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM

1818 H Street N.W.

(202) 473-1000

Washington, D.C. 20433

Adresa kablllore: INTBAFRAD

SHBA

Adresa kablllore: INDEVAS

Sh.T.Z Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr. 4, Tiranë
Republika e Shqipërisë

_____, 2016

Lënda: Republika e Shqipërisë
Granti nr. TF014255 - Granti Suedeze për Bashkëfinancimin e
Projekti për Burimet Ujore dhe Ujitjen në Shqipëri
Ndryshim

Shkëlqesi,

Në këtë shkresë i referohemi Marrëveshjes së Grantit (Marrëveshja), të datës 30 maj 2013, të lidhur
ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e
administratorit të fondeve të grantit të ofruara nga Suedia, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për
Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar (SIDA) (Donatori) dhe Republikës së Shqipërisë
(Marrësi). Në përgjigje të shkresës suaj drejtuar Bankës Botërore, më 8 shtator 2015, Banka Botërore
propozon ndryshimin e Marrëveshjes si më poshtë:



1. Seksioni 2.02 i aneksit të Marrëveshjes, ndryshon duke hequr fjalët “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU)” dhe duke i zëvendësuar me “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)”.

2. Seksionet e mëposhtme në aneksin e Marrëveshjes ndryshojnë duke hequr fjalët “MBUMK” dhe “MMPAU” dhe duke i zëvendësuar me “MBZHRAU”:

- i) Seksioni 2.04 (a) dhe (c);
- ii) Seksioni 2.06 (a);
- iii) Seksioni 2.07 (b) dhe (c);
- iv) Seksioni 2.08 (a) (iii);

3. Tabela në nenin III të aneksit të Marrëveshjes ndryshon si më poshtë:

Kategori	Shuma e Grantit (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallra (përveç mallrave për pjesën 3(c) të Projektit), shërbime konsultive, trajnim, shërbime teknike dhe kosto operative rritëse për Projektin	3.536.000.	100%
2. Mallra për pjesën 3 (c) të Projektit	339.000.	55%
TOTALI	3.875.000.	

Për qëllim të këtij seksioni, “Kosto operative rritëse” janë kostot administrative me rritje të arsyeshme graduale të MBZHRAU-së, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, pajisjet, materialet dhe furnizimet, kostot e komunikimit dhe kostot e karburantit për vizitat në terren.

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes, të cilat nuk kanë ndryshuar, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, duke nënshkruar dhe vendosur datën dhe më pas na e dërgoni kopjen e kësaj shkresë ndryshimi. Kjo shkresë ndryshimi hyn në fuqi nga data në të cilën Banka Botërore i dërgon Marrësit njoftimin e pranimit të saj që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj shkresë Ndryshimi është autorizuar ose ratifikuar siç duhet me anë të të gjithë hapave të nevojshëm qeveritarë.

Me respekt

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ellen Goldstein

Drejtore për vendin, Evropa Juglindore
Evropa dhe Azia Qendrore

MIRATUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____



VENDIM
Nr. 23, datë 20.4.2016
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
 e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.11.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 25/1 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Komanda e Forcave Ajrore, Reparti Usharak nr. 3001, Rinas, Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vendimeve nr. 00-2014-1797, datë 3.6.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 1650, datë 15.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pezullimi i gjykimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor dhe zhvillimi i gjykimit incidental për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të pikës 3, të nenit 289, të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 42, 131/f, 134/g dhe 145/2 të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; nenet 28, 29, 30, 68 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës,

prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 10222, datë 4.2.2010, miratoi kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe shoqërisë “Eurocopter” s.a.s. Objekt i kontratës së miratuar ishte furnizimi i Forcave të Armatosura të RSH-së me 5 (pesë) helikopterë. Programi i zbatimit të kontratës do të shtrihej në disa vite buxhetore dhe ligji i mësipërm ngarkonte Ministrinë e Mbrojtjes me përgjegjësinë e planifikimit të fondeve përkatëse për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2. Në përputhje me kontratën e lidhur në datën 3.12.2012 dhe 25.4.2013 pranë Degës së Doganës Rinas kanë mbërritur në emër dhe për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes dy mjete ajrore të dërguara nga kompania “Eurocopter” s.a.s, me të dhënat e mëposhtme: a) helikopter tip “AS 532 AL COUGAR ALB 3 MEDAVEC, me S/N 2807 dhe numër anësor 631, me një vlerë totale prej 15,237,922.80 eurosh (ardhur në datën 3.12.2012); dhe b) helikopter tip AS 532 AL COUGAR ALB 3 MEDAVEC, me S/N 2816 dhe numër anësor 632, me një vlerë totale prej 15,237,922.80 eurosh.

3. Ministria e Mbrojtjes, për shkak të mungesës së fondeve në momentin e mbërritjes së helikopterëve, i ka kërkuar Degës së Doganës Rinas shtyrjen e afatit të pagesës së TVSH-së për këto objekte. Dega e Doganës Rinas e ka refuzuar miratimin e kërkesës për shtyrje afati. Pas miratimit të fondeve përkatëse për likuidimin e detyrimeve doganore, në datën 9.12.2013, nëpërmjet agjencisë doganore “Zoto trans”, janë përpiluar deklaratat doganore nr. R24534 dhe nr. R24533, të cilat janë dorëzuar tek autoritetet doganore kompetente të Sektorit Cargo/Regjime pranë Degës së Doganës Rinas.

4. Nga doganierët përgjegjës, pas verifikimit të dokumentacionit, është konkluduar se paraqitja e deklaratave doganore është bërë tej afateve të parashikuara në nenin 74/1/b, të Kodit Doganor. Bazuar në nenet 285 dhe 286 të Kodit Doganor, pas konstatimit të këtij fakti nga



punonjësit përgjegjës të Sektorit Cargo/Regjime, janë mbajtur procesverbalet përkatëse (nr. 242 prot., datë 17.1.2014 dhe 23.1.2014, si dhe nr. 4842 prot., datë 9.12.2013 dhe 10.12.2013). Bazuar në nenin 274/1/2 të Kodit Doganor është propozuar ndëshkimi i subjektit me gjobë në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë për çdo ditë vonesë, për shkak të mosparaqitjes së deklaratave doganore brenda afateve të parashikuara.

5. Propozimi i mësipërm është miratuar nga Dega e Doganës Rinas, e cila, me vendimin nr. 6, datë 22.1.2014, ka vendosur: *“Të ndëshkojë subjektin ‘Reparti Ushtarak 3001’ me nr. NIPT-i: K51723037A, me adresë pranë Komandës së Forcave Ajrore, Rinas, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me një gjobë prej 20.000 lekësh për 222 ditë vonesë referuar deklaratës doganore IM-4 me nr. R 24533, datë 9.12.2013. Subjekti ‘Reparti ushtarak 3001’, me nr. NIPT-i: K 51723037 A, me adresë, pranë Komandës së Forcave Ajrore, Vaqarr, Rinas, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, të paguajë gjithsej shumën prej 4.440.000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekësh.”*

Gjithashtu, Dega e Doganës Rinas, me vendimin nr. 7, datë 24.1.2014, ka vendosur: *“Të ndëshkojë subjektin ‘Reparti Ushtarak 3001’ me nr. NIPT-i: K51723037A, me adresë pranë Komandës së Forcave Ajrore, Rinas në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me një gjobë prej 20.000 lekësh për 365 ditë vonesë referuar deklaratës doganore IM-4 me nr. R 24534, datë 9.12.2013. Subjekti ‘Reparti Ushtarak 3001’, me nr. NIPT-i: K51723037A, me adresë pranë Komandës së Forcave Ajrore, Rinas, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, të paguajë gjithsej shumën prej 7,300,000 (shtatë milionë e treqind mijë) lekësh.”*

7. Vendimet e mësipërme janë kundërshtuar nga kërkesja pranë drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Ky i fundit, me shkresat nr. 3007/1 dhe nr. 3013/1, datë 18.2.2014, i ka kthyer praktikat pa veprime, me argumentimin se kërkesat ankimore nuk përmbajnë pagesat në zbatim të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 289/3 të Kodit Doganor.

8. Kërkesja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shfuqizimin e të dyja vendimeve të Degës së Doganës Tiranë. Në këtë gjykim, kërkesja i parashtroi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe neneve 68 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të vendosë pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e nenit 289/3 të Kodit Doganor.

9. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 1650, datë 15.4.2014, vendosi: *“Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor”*.

10. Kundër këtij vendimi kërkesja ushtroi ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 31003-01933-00-2014, datë 3.6.2014, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1650, datë 15.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”*

II

11. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

11.1. *Është cenuar parimi i arsytimit të vendimit gjyqësor.* Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nuk është arsyetuar në përputhje me standardin kushtetues të vendosur edhe nga praktika e Gjykatës Kushtetuese. Që në seancën e parë u kërkuar që gjykata të pezullonte gjykimin e çështjes dhe të vendoste dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për të kontrolluar pajtueshmërinë e nenit 289/3 të Kodit Doganor me Kushtetutën. Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës pa dhënë asnjë shpjegim si në vendimin e ndërmjetëm, ashtu edhe në vendimin përfundimtar. Një gjë e tillë bie ndesh me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Të njëjtën shkelje ka bërë edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos bërë një analizë të plotë të kërkesës së kërkeses për mungesë arsytimi nga gjykata më e ulët.

11.2. *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.* Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e nxori çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, duke mos dhënë zgjidhje përfundimtare për çështjen objekt konflikti. Ajo, gjithashtu, nuk përcaktoi në vendimin e saj se cila ishte gjykata ose organi kompetent që duhej të zgjidhte konfliktin. Kjo shkelje nuk u riparua as nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili la në fuqi vendimin e ankimuar, duke mohuar përfundimisht aksesin në gjykatë.

11.3 Përveç shfuqizimit të këtyre vendimeve si antikushtetuese, kërkesja mendon se e vetmja



mënyrë për të riparuar të drejtën është që Gjykata Kushtetuese jo vetëm të shfuqizojë vendimet e gjykatave sipas objektit të kërkesës, por edhe të ushtrojë një kontroll kushtetutshmërie të nenit 289/3 të Kodit Doganor, i cili cenon të drejtën për akses dhe ankim në gjykatë. Ajo e mbështet këtë pretendim në faktin se nuk ka asnjë mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtën e saj, pasi gjykatat ia kanë mohuar të drejtën për t'iu drejtuar juridiksionit gjyqësor. Ankimi kushtetues është i vetmi mjet me të cilin ajo mund të rivendosë në vend të drejtën e saj kushtetuese për t'iu drejtuar gjykatës, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës.

12. Subjekti i interesuar, **Këshilli i Ministrave**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

12.1 Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet që lidhen me cenimin e procesit të rregullt ligjor, pasi ajo është subjekt i së drejtës publike dhe si e tillë e ka të kufizuar hapësirën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

12.2 Pretendimi për cenimin e parimit të aksesit në gjykatë është i pabazuar, pasi gjykimi i kësaj çështjeje është zhvilluar në të gjitha shkallët e gjyimit dhe gjykatat kanë vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi kërkuesja nuk kishte përmbushur kriterin ligjor të parapagimit të të gjithë detyrimit doganor para se t'i drejtohet gjykatës.

12.3 Pretendimi se neni 289/3 i Kodit Doganor cenon të drejtën e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës nuk qëndron, pasi ai është në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Neni 289/3 i Kodit Doganor përmban një kufizim të vendosur me ligj për të përmbushur një interes publik dhe është në përputhje me gjendjen e krijuar, si i tillë nuk cenon thelbin e së drejtës së ankimit dhe nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

13. Subjekti i interesuar, **Ministria e Financave**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

13.1 Kërkuesja nuk legjitimohet si subjekt për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi ajo është në varësi të Këshillit të Ministrave dhe interesat e saj mund t'i realizojë vetëm nëpërmjet Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, kërkuesja nuk legjiti-

mohet të kërkojë shfuqizimin e një ligji, referuar nenit 49, të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

13.2 Gjykatat kanë vendosur me të drejtë nxjerrjen jashtë juridiksionit, për shkak se kërkuesja nuk kishte paguar paraprakisht detyrimin doganor, si kusht për t'iu drejtuar gjykatës. Gjithashtu, Ministria e Financave është e mendimit se nuk ka vend për ushtrimin e një kontrolli incidental, pasi që gjykata të ushtrojë një kontroll incidental para Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë në kushte të tilla që të mos ketë asnjë mundësi tjetër për të zgjidhur çështjen, për shkak të antikushtetueshmërisë së ligjit ku duhet të mbështetet gjykata. Në rastin konkret, Gjykata Administrative e Shkallë së Parë dhe Kolegji Administrativ nuk kanë arritur në përfundimin se duhet të ushtrojnë kontroll incidental. Si rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe bashkë me të edhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

13.3 Pretendimi se neni 289/3 i Kodit Doganor cenon të drejtën e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës nuk qëndron. Ai është në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, përmban një kufizim të vendosur me ligj për të përmbushur një interes publik, dhe është në përputhje me gjendjen e krijuar, si i tillë nuk cenon thelbin e së drejtës së ankimit dhe as nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Vjelja e detyrimeve doganore dhe të ardhurave të tjera buxhetore është një nga burimet kryesore të realizimit të fondeve të buxhetit të shtetit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses dhe juridiksionin e Gjykatës

14. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, individët kanë legjitimitet të kushtëzuar, për arsye se mund t'i drejtohen Gjykatës vetëm për pretendime të lidhura me



procesin e rregullt ligjor, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Për sa i takon legjitimitet *ratione personae*, Komanda e Forcave Ajrore është një subjekt që legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj gjykate, pasi, si palë e paditur në gjykim, ajo ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, si dhe së drejtës për arsyetim të vendimit gjyqësor, si elemente të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka bërë dallimin e legjitimitetit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimiteti i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. E drejta për akses në gjykatë, si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet e të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces dhe që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë prej tij. Një e drejtë e tillë nuk mund të cenohet, sepse duke qenë një element i së drejtës në tërësi dhe që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës, garanton barazinë e palëve në procesin gjyqësor. Për këtë arsye ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases në lidhje me cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe të standardit të arsyetimit të vendimit përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për pasojë, kërkuessa legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për akses në gjykatë

16. Gjykata thekson se e drejta e aksesit në gjykatë është e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo shoqërohet më tej edhe me një garanci tjetër të parashikuar në nenin 43, i cili garanton të drejtën e ankimit ndaj çdo vendimi gjyqësor ose administrativ, me qëllim që shtetasve të mos u cenohet liria, prona dhe të drejta të tjera të ligjshme pa një proces të rregullt. Lidhur me të drejtën e aksesit, në jurisprudencë të vazhdueshme Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi nga ana e gjykatës, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka theksuar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009*).



18. Ky qëndrim i Gjykatës është në një linjë me qëndrimet tashmë të konsoliduara të GJEDNJ-së apo gjykatave të tjera simotra. GJEDNJ-ja që në vitin 1975, në çështjen *Golder kundër United Kingdom* (çështja 4451/70, vendimi datë 21.2.1975, § 35), është shprehur se “do të ishte e pakonceptueshme, sipas mendimit të gjykatës, që neni 6, § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojë në radhë të parë atë që në fakt bën të mundur përfitimën e garancive të tilla, që është aksesit në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia, nuk do të kenë fare vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore”. Pra, duke bërë një interpretim të të “drejtave efektive”, GJEDNJ-ja në vendimin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* përcaktoi se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor.

19. Duke iu referuar rastit konkret, Gjykata konstaton se kërkesja, e ndodhur para rrethanave faktike që nuk i linin asaj asnjë hapësirë ligjore për ta zgjidhur në rrugë administrative çështjen e bllokimit nga Dogana Dega Rinas të 2 helikopterëve të blerë, por të pazhdoganuar, i është drejtuar sipas rregullave procedurale gjykatës, si mjeti i fundit efektiv për vendosjen në vend të së drejtës së mohuar.

20. Kërkesja ka kërkuar, sipas objektit të padisë, shfuqizimin e vendimeve nr. 6, datë 22.1.2014 dhe nr. 7, datë 24.1.2014 të Degës së Doganës Rinas. Në kërkesëpadinë e saj ajo ka argumentuar se detyrimi i subjektit për të paguar 40% të gjobës, referuar edhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, është antikushtetues, pasi nuk respekton parimin e proporcionalitetit për kufizimin që parashikon. Për këtë shkak, ajo i ka kërkuar gjykatës që në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe neneve 68 e vijues të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të vendosë pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e nenit 289/3 të Kodit Doganor. Këtë kërkim kërkesja e ka bazuar te fakti se gjykata për zgjidhjen e çështjes do t’i referohej detyrimisht këtij ligji, pasi mbi bazë të tij kishin dalë 2 vendimet e Doganës Rinas që kundërshtoheshin

nga kërkesja. Me vendimin nr. 1650, datë 15.4.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi: “Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.” Kundër këtij vendimi kërkesja ushtroi ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 31003-01933-00-2014, datë 3.6.2014, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 1650, datë 15.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”

21. Gjykata çmon se është detyrë parësore e gjykatave të vlerësojnë të gjithë situatën juridike normative dhe faktike për të përcaktuar se cila është gjykata kompetente që duhet të shqyrtojë konfliktin dhe t’i japë zgjidhje përfundimtare. Referuar vendimit të gjykatës administrative, rezulton se ajo gjykatë nuk ka bërë as hetim, as vlerësim të plotë të situatës juridike apo të kushtetutshmërisë së normës, megjithëse kjo është kërkuar nga kërkesja që në fillim të gjykimit, i cili ka argumentuar se përmbajtja e normës sillte cenim të drejtpërdrejt të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës. Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë nuk e ka marrë fare në shqyrtim pretendimin e kërkeses lidhur me faktin nëse ligji kufizonte ose jo në mënyrë antikushtetuese të drejtën e aksesit të saj në gjykatë. Kjo gjë vërtetohet nga arsyetimi i vendimit të asaj gjykate, ku nuk pasqyrohet asnjë argument lidhur me këtë pretendim të kërkeses. Ky qëndrim bie ndesh edhe me parimin e disponibilitetit, sipas të cilit gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkimet e paditësit.

22. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është e pakufizueshme, por kufizimi i saj duhet të respektojë në çdo rast kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, i cili shtrihet ndaj të gjitha të drejtave të parashikuara në Kushtetutë. Kufizimi duhet të bëhet vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës dhe garancisë (*shih vendimin nr. 40, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, gjithashtu, ka çmuar se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht



formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 52, datë 2.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nisur nga këto kritere të parashikuara nga Kushtetuta, si dhe të elaboruara në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë duhej t'i kishte bërë të gjitha përpjekjet për t'i dhënë përgjigje kërkuarës nëse pretendimet e saj ishin ose jo të bazuara. Vetëm pas dhënies së një përgjigjeje të argumentuar për pretendimet e kërkuarës, mund të thuhet se gjykata ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuarës. Pavarësisht përfundimit në të cilin do të kishte arritur gjykata, sipas bindjes së saj, e drejta e kërkuarës për t'iu drejtuar gjykatës do të konsiderohej e realizuar efektivisht dhe do të kishte çuar në shmangien e situatës aktuale në të cilën ndodhet kërkuarja, e cila nuk ka një vendim përfundimtar për zgjidhjen e konfliktit.

24. Të njëjtën shkelje ka bërë edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Kolegji ka arsyetuar se është në vlerësimin e gjykatës ta referojë ose jo çështjen për gjykim në Gjykatën Kushtetuese. Natyrisht është e drejtë e gjykatës, që kryesisht ose me kërkesë të palëve, të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjit të zbatueshëm prej saj, por vetëm pasi ajo të ketë kryer një hetim të plotë të pretendimeve dhe të fakteve të çështjes konkrete dhe në fund të hetimit gjyqësor, bazuar mbi argumente juridike, të vendosë për dërgimin ose jo të çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës. Për këtë shkak, Gjykata çmon se shkelja e bërë nga gjykata e shkallë së parë nuk është riparuar as nga Kolegji Administrativ, si gjykatë më e lartë.

25. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarës për cenimin e aksesit në gjykatë është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që

cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimit gjyqësor është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Gjykata e ka vlerësuar kërkesën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik



(shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Gjykata, referuar rastit konkret, çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe ai i Kolegjit Administrativ nuk i kanë përmbushur standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor duke mos u dhënë përgjigje kërtimeve të kërkuësës, të cilat kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes në themel. Gjykatat kanë shqyrtuar vetëm kushtet për ngritjen e padisë, pra parapagimin e detyrimeve doganore nga kërkuësja, pa i hyrë vlerësimit të rrethanave dhe fakteve se përse kërkuësja nuk i kishte përmbushur pjesërisht këto kriteret. Në fund të gjykimit gjykatat kanë vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit pa u dhënë përgjigje të argumentuara kërtimeve të kërkuësës. Si rrjedhim, gjykatat nuk kanë plotësuar standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese për arsytimin e vendimit gjyqësor, gjë që ka sjellë cenimin e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

29. Nisur nga sa më lart, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat faktike të çështjes, çmon se në kuptimin kushtetues kërkuësës i është mohuar e drejta për të pasur vendime gjyqësore të arsyetuara sipas standardeve kushtetuese. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës për këtë pretendim është i bazuar dhe duhet pranuar.

Ç. Për pretendimin e shfuqizimit të nenit 289/3 të Kodit Doganor

30. Kërkuësja ka kërkuar, gjithashtu, edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor, duke argumentuar se kjo dispozitë cenon drejtpërdrejt të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi detyron subjektet të parapagujnë 40% të gjobës dhe kamatëvonesat e vendosura nga doganat para se të ushtrojnë të drejtën e ankimit.

31. Gjykata çmon se kërkuësja, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1/g të Kushtetutës, i është drejtuar kësaj Gjykate duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si antikushtetuese, me cilësinë e palës në këtë gjykim, si dhe ushtrimin e një kontrolli incidental nga Gjykata për të shfuqizuar nenin 289/3 të Kodit Doganor, mbi të cilin është mbështetur gjykata e faktit në dhënien e vendimit. Gjykata vlerëson se detyrimi për të iniciuar një kontroll

incidental para saj u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, kur ato çmojnë se ligji mbi të cilin duhet të bazohen për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi është antikushtetues. Palët kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata nisjen e një kontrolli konkret antikushtetutshmërie, por në fund është gjykata ajo që vendos dhe palët nuk mund të kërkojnë drejtpërdrejt një kontroll të tillë para Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, Gjykata çmon se kërkuësja nuk është një nga subjektet që mund të kërkojnë fillimin e një kontrolli incidental para kësaj Gjykate.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuësja nuk legjitimohet në kërkimin e saj për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor.¹

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,²

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1650, datë 15.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 00-2014-1797, datë 3.6.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 - Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Votuan pro për pranimin e këtij kërkit gjyqtarët S. Berberi dhe G. Dizdari. Këta gjyqtarë bashkohen me qëndrimin e Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, por me mendim paralel.

² Gjyqtari V. Kristo votoi edhe për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, sepse gjykatat, në funksion të realizimit të së drejtës së aksesit, duhet të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë ligjore, përfshirë rrugën e gjykimit incidental për kushtetutshmërinë e normës juridike në fjalë.



Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Bashkohemi me qëndrimin e shumicës për shfuqizimin e vendimeve nr. 1650, datë 15.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 00-2014-1797, datë 3.6.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, por nuk bashkohemi me linjën e arsytimit që ka ndjekur shumica në këtë vendim, si dhe me rrëzimin e kërkesës lidhur me kontrollin e kushtetutshmërisë dhe shfuqizimin e nenit 289/3 të Kodit Doganor. Në vijim, vlerësimi i kërtimeve për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe dispozitës ligjore është bërë veçmas, duke paraqitur dhe argumentet përkatëse.

a) Për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore

2. Kërkesja ka pretenduar se nëpërmjet vendimeve gjyqësore objekt kërkesë i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë dhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Shumica ka arritur në konkluzionin se të dyja këto pretendime janë të bazuara. Ne bashkohemi vetëm me konkluzionin se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Lidhur me pretendimin për cenimin e aksesit në gjykatë, siç do të shpjegohet më poshtë, shkak për këtë cenim, nuk janë vendimet gjyqësore por është dispozita ligjore, konkretisht neni 289/3 i Kodit Doganor.

3. Siç ka argumentuar me të drejtë shumica “[...] është detyrë parësore e gjykatave të vlerësojnë të gjithë situatën juridike normative dhe faktike për të përcaktuar se cila është gjykata kompetente që duhet të shqyrtojë konfliktin dhe t’i japë zgjidhje përfundimtare. Referuar vendimit të gjykatës administrative, rezulton se ajo gjykatë nuk ka bërë as betim, as vlerësim të plotë të situatës juridike apo të kushtetutshmërisë së normës, megjithëse kjo është kërkuar nga kërkesja që në fillim të gjykimit, i cila ka argumentuar se përmbajtja e normës sillte cenim të drejtëpërdrejt të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës. Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë nuk e ka marrë fare në shqyrtim pretendimin e kërkeses lidhur faktin nëse ligji kufizonte ose jo në mënyrë antikushtetuese të drejtën e aksesit të saj

në gjykatë. Kjo gjë vërtetohet nga arsyetimi i vendimit të asaj gjykate, ku nuk pasqyrohet asnjë argument lidhur me këtë pretendim të kërkeses [...]. Ky qëndrim bie ndesh edhe me parimin e disponibilitetit, sipas të cilit gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkimet e paditësit...” (shih paragrafët 21, 23, 24 të vendimit).

4. Në këtë çështje çmojmë se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe ai i Kolegjit Administrativ nuk i kanë përmbushur standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor, duke mos u dhënë përgjigje kërtimeve të kërkeses, të cilat kishin rëndësi për garantimin e një procesi të rregullt ligjor dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Ato nuk kanë hetuar dhe nuk kanë vlerësuar situatën juridike normative dhe faktike të rastit konkret, si dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kushtetutshmërisë së normës. Kjo kërkesë, megjithëse është ngritur nga kërkesja që në fillim të gjykimit, pasi ajo ka qenë e bindur se përmbajtja e normës sillte cenim të drejtëpërdrejt të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata e faktit, gjë që vihet re në vendimin e saj, ku nuk pasqyrohen argumente lidhur me këtë kërkim. Arsyetimi i vendimit gjyqësor është detyrim kushtetues që duhet realizuar në përputhje me standardet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe dispozitat përkatëse procedurale. Për më tepër, duke pasur parasysh rrethanat konkrete, ku është ngritur nga kërkesja një çështje kushtetutshmërie, dhënia e përgjigjes së argumentuar nga gjykata ka pasur akoma më tepër rëndësi. Për sa më sipër, vlerësojmë se pretendimi i kërkeses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar dhe shfuqizimi i vendimeve gjyqësore, objekt shqyrtimi, është rrjedhojë e këtij cenimi.

b) Për kontrollin e kushtetutshmërisë dhe shfuqizimin e nenit 289/3 të Kodit Doganor

5. Shumica, në lidhje me këtë kërkim të kërkeses, është shprehur se “detyrimi për të iniciuar një kontroll incidental para saj u takon gjykatave të juridiksionit të zëkonshëm, kur ato çmojnë se ligji mbi të cilin duhet të bazohen për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi është antikushtetues. Palët kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata nisjen e një kontrolli konkret antikushtetutshmërie, por në fund është gjykata ajo që vendos dhe palët nuk mund të kërkojnë drejtëpërdrejt një kontroll të tillë para Gjykatës Kushtetuese. Për këtë



arsye, Gjykata çmon se kërkesja nuk është një nga subjektet që mund të kërkojnë fillimin e një kontrolli incidental para kësaj Gjykate. Kërkesja nuk legjitimohet në kërkimin e saj për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor” (§ 31–32 të vendimit). Nuk biem dakord me këtë qëndrim të shumicës për arsyet në vijim.

c) *Për legjitimimin e kërkeses për të kërkuar shfuqizimin e nenit 289/3 të Kodit Doganor*

6. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Ajo, bazuar në nenet 134/1/g dhe 134/2, vihet në lëvizje me kërkesë të individëve, të cilët mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Nga interpretimi literal dhe sistematik i këtyre dispozitave konkludohet se: i) individët, si subjekte kërkuuese të kushtëzuara, duhet të kenë interes legjitim për t’u drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pra vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre; ii) pretendimet e tyre duhet të jenë të fokusuara në të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor; iii) përpara se t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese individët duhet të shterojnë të gjitha mjetet juridike efektive për të vendosur në vend të drejtat e tyre; iv) akti i kundërshtuar përpara Gjykatës Kushtetuese mund të jetë vendim gjyqësor, por edhe akt normativ që cenon procesin e rregullt ligjor.

7. Bazuar në sa më sipër, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se kërkesja legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate. Ajo i plotëson të gjitha kushtet e sipërpërmendura, pasi ka justifikuar interesin legjitim në çështjen konkrete (*të drejtën e shkelur*), pretendimet e saj bien në fushëveprimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*e drejta e ankimit dhe e drejta e aksesit në gjykim*), ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion, si dhe ka kundërshtuar një akt normativ (*neni 289/3 i Kodit Doganor*), që sipas saj cenon procesin e rregullt ligjor, konkretisht të drejtën e aksesit në gjykim. Nga rrethanat faktike vërehet se gjykata e faktit, në vendimin e dhënë, ka mbajtur qëndrimin se kërkesja nuk mund t’i drejtohet gjykatës për të zgjidhur konfliktin, pasi neni 289/3 i Kodit Doganor nuk e lejon ankimin gjyqësor pa plotësuar kushtet për këtë qëllim,

konkretisht parapagimin e detyrimit doganor dhe 40% të gjobës. Rrjedhimisht, në këtë rast i vetmi mjet me të cilin ajo mund të rivendoste në vend të drejtën e saj kushtetuese për t’iu drejtuar gjykatës, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, do të ishte shqyrtimi i kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor nga vetë Gjykata Kushtetuese, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë pranuar kërkesën e kërkeses për pezullimin e gjykimit të çështjes dhe inicimin e një kontrolli incidental para kësaj Gjykate. Për pasojë, kërkesja, në vlerësimin tonë, legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor, pasi i plotëson kushtet e parashikuara në nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës.

ç) *Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 289/3 të Kodit Doganor*

8. Kërkesja ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor, duke argumentuar se kjo dispozitë cenon drejtpërdrejt të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi detyron subjektet të parapaguajnë 40% të gjobës dhe kamatëvonesat e vendosura nga doganat para se të ushtrojnë të drejtën e ankimit.

9. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, përveç prapësimeve në lidhje me legjitimimin e kërkeses, kanë parashtruar edhe argumente kundërshtuese për sa i përket themlit të pretendimit për papajtueshmëri me Kushtetutën të nenit 289/3 të Kodit Doganor. Kështu, Këshilli i Ministrave ka parashtruar se pretendimi i cenimit të së drejtës së kërkeses për t’iu drejtuar gjykatës nga neni 289/3 i Kodit Doganor nuk qëndron, pasi ky nen është në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Neni 289/3 i Kodit Doganor përmban një kufizim të vendosur me ligj për të përmbushur një interes publik dhe është në përputhje me gjendjen e krijuar, si i tillë nuk cenon thelbin e së drejtës së ankimit dhe nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në KEDNJ (§ 12.3 i vendimit). Të njëjtën linjë arsyetimi ka përdorur edhe Ministria e Financave, sipas së cilës kufizimi i vendosur për të drejtën e ankimit justifikohet me faktin se vjelja e detyrimeve doganore dhe të ardhurave të tjera buxhetore është një nga burimet kryesore të realizimit të fondeve të buxhetit të shtetit.



10. Shumica ka çmuar se kërkesja nuk legjitimohet në kërkimin e saj për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/3 të Kodit Doganor. Ne jemi të qëndrimit se shumica duhej të kishte shkuar më tej, duke kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së normës për ta bërë ankimin para saj një mjet efektiv, si dhe për të garantuar një proces të rregullt edhe përpara gjykatave të zakonshme. Është qartazi e dukshme se përmbajtja e nenit 289/3 të Kodit Doganor e kufizon ankimin administrativ dhe gjyqësor, rrjedhimisht edhe aksesin në gjykatë, me parapagimin e detyrimit doganor bashkë me 40% të gjobës mbi këtë vlerësim. Pra, në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë që shkaktohet nga vetë norma dhe jo nga gjykatat e zakonshme, të cilat thjesht dhe vetëm kanë zbatuar normën. Çështja që shtrohet dhe që duhej të shqyrtohej nga Gjykata është nëse ky kufizim i së drejtës së aksesit është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 17/1 të Kushtetutës. Ky nen parashikon se “kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”. Në këtë mënyrë, pajtueshmëria e masës kufizuese të marrë nga ligjvënësi me ekzistencën e nevojës së kufizimit duhet të verifikohet në aspektin e kushteve të vendosura në nenin 17 të Kushtetutës. Kushti i parë është ekzistenca e “interesit publik”. Një kusht tjetër që duhet të respektojë ligjvënësi në vendosjen e kufizimit është që ky kufizim të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, çka e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Mjetet e zgjedhura duhet të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen dhe përdorimi i tyre të jetë i domosdoshëm, që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak kufizuese për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar

edhe mënyrën e kufizimit (*shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Interesi publik në rastin konkret është vjelja në mënyrë efektive e detyrimeve doganore. Për të realizuar këtë qëllim ligjvënësi, nëpërmjet nenit 289/3 të Kodit Doganor ka kufizuar të drejtën e aksesit dhe ankimit të individëve në gjykatë. Në një rast të ngjashëm, Gjykata ka argumentuar se nuk vihet në dyshim që grumbullimi efektiv i detyrimeve që shtetasit kanë kundrejt shtetit përbën një interes të ligjshëm publik, më se të mjaftueshëm për të justifikuar kufizime të të drejtave të shtetasve, por me kusht që ato të jenë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Një ndërhyrje shtetërore, e cila kufizon të drejta të ligjshme të shtetasve, mund të ndërmerret kur është e domosdoshme dhe nuk ekziston asnjë rrugë tjetër për të mundësuar arritjen e interesave publikë. Ndërhyrja në asnjë rast nuk mund të cenojë thelbin e së drejtës dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me situatën që ka diktuar hartimin e normës kufizuese. Para së gjithash, mjeti i përdorur duhet të jetë efikas, në mënyrë që të mos kemi një cenim a mohim të të drejtave të individëve pa u arritur realizimi i interesit publik, në funksion të së cilit është hartuar norma juridike. Mjeti duhet të jetë i tillë që të shmangë, sa më shumë të jetë e mundur, kufizimet e të drejtave të individëve në raport me rezultatet që kërkohen të arrihen. Ky konkretizim i parimit të proporcionalitetit detyron ligjvënësin që në çdo rast të vërë në balancë përfitimet publike në raport me cenimin e të drejtave të individëve, duke pasur si kufizim logjik dhe juridik të përfitimeve publike, thelbin e së drejtës së individëve (*shih vendimin nr. 18, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në po këtë vendim (nr. 18/2010) Gjykata, duke iu referuar edhe vendimit nr. 16/2008 të saj, ka bërë dallimin midis gjobës, që ka karakter ndëshkues dhe vlerës së detyrimit doganor apo tatimor, që ka karakter detyrues. Ajo ka vlerësuar se “vjelja e detyrimeve tatimore mund të arrihej, bazuar në legjislacionin administrativ në fuqi, pa vendosur kufizime të aksesit të individëve për t’ju drejtuar gjykatës, të cilat mund të prekin thelbin e së drejtës. Konkretisht, ajo i është referuar Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit



ekzekutimi i detyrimeve të parashikuara në aktin administrativ mund të bëhet forcërisht nga administrata, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar gjykatës, me kusht që ekzekutimi të bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit (shih nenin 130). Gjithashtu, në nenin 138 të këtij Kodi parashikohet se ankimi administrativ pezullon zbatimin e aktit administrativ me përjashtim të rastit kur akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore. Në këto kushte organet doganore i kanë të gjithë tagrat që të veprojnë me anë të ekzekutimit të detyrues kundrejt debitorëve të tyre, të cilët edhe nëse ankohen, nuk kanë të drejtë të përfitojnë pezullimin e ekzekutimit kundrejt pasurisë së tyre, si pasojë e ankimit administrativ ose gjyqësor. Pikërisht për këto arsye Gjykata, ashtu si dhe në rastin e gjobave tatimore (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se objektivi i ligjshëm shtetëror për të rritur efektivitetin e vjeljes së detyrimeve doganore mund të realizohet pa cenuar të drejtën e individëve për t'iu drejtuar gjykatës” (*shih vendimin nr. 18, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke krahasuar rastin konkret me çështjen e shqyrtuar nga Gjykata në vendimin e saj nr. 18/2010, ku është diskutuar parashikimi i nenit 289/5 të Kodit Doganor, që ka vendosur kufizim të ngjashëm me parashikimin e nenit 289/3 të Kodit Doganor, rezulton se këto çështje janë thujse identike. Në të dyja rastet ballafaqohen dy interesa të mbrojtur nga Kushtetuta, nga njëra anë, e drejta e shtetasve për të pasur një akses efektiv në një proces të drejtë para një gjykate të paanshme dhe të pavarur, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, dhe, nga ana tjetër, interesi i shtetit për të vjelë në mënyrë efektive detyrimet doganore, duke kufizuar të drejtën e aksesit të individëve në gjykatë. Për rrjedhojë, e njëjta logjikë dhe i njëjti arsyetim i përdorur nga Gjykata në vendimin nr. 18/2010 vlen edhe në rastin konkret.

14. Për më tepër, theksojmë se vetëm shfuqizimi i vendimeve gjyqësore, duke ia kaluar sërish çështjen gjykatave të zakonshme, pa kryer një kontroll kushtetutshmërie mbi normën, nuk do të sjellë asnjë pasojë pozitive për kërkuesen. Ne vlerësojmë se kthimi i çështjes për rigjykim në gjykatat e faktit do të sjellë zvarritjen e

procesit si pasojë e rigjykimit, duke lënë pa zgjidhur shkakun e cenimit të aksesit. Kjo zgjatje e gjykimit mund të ishte shmangur nëse Gjykata do të shqyrtonte kushtetutshmërinë e nenit 289/3 të Kodit Doganor, do të shfuqizonte këtë nen dhe pastaj do të kthente çështjen për rigjykim në gjykatën e faktit. Në këtë mënyrë gjykimi kushtetues do të ishte një mjet efektiv për kërkuesen, në përputhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

15. Nisur nga sa më sipër, çmojmë se shumica duhej të kishte shqyrtuar përmbajtjen e nenit 289/3 të Kodit Doganor, e cila kufizon haptazi dhe cenon në thelb të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor ndaj vendimeve për pagimin e detyrimeve doganore. Ne gjyqtarët në pakicë, për sa i takon kërkimit për shfuqizimin e ligjit ku bazohen vendimet gjyqësore të kundërshtuara, jemi të qëndrimit se ky kërkim është i bazuar dhe duhej të pranohej nga shumica.

d) Për detyrimet që neni 145 i Kushtetutës i imponon gjykatës për vënien në lëvizje të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës

16. Sipas nenit 145/2 të Kushtetutës kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tyre. Parashikimi në Kushtetutë i kontrollit të kushtetutshmërisë vë në dukje rëndësinë që ka ky kontroll nga të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe në fund në mënyrë përfundimtare nga Gjykata Kushtetuese. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental. Gjykata e zakonshme, në rastet kur shqyrton paraprakisht, kryesisht ose me kërkesë të palës, lidhur me kushtetutshmërinë e normës ka detyrimin të bëjë një analizë të thellë dhe të argumentuar të normës, në funksion të përmbushjes së kriterëve për iniciimin e gjykimit incidental. Ajo, në raste të tilla, duhet të analizojë situatën faktike dhe juridike ku aplikohet norma, të drejtat e individit të cilat pretendohet se cenohen nga norma,



kuadrin ligjor ekzistues dhe mënyrat e mundshme për ta interpretuar normën në pajtim me Kushtetutën, si dhe të parashtrijë argumente të bazuara dhe të arsyetuara për sa i përket vlerësimit dhe bindjes së saj lidhur me kushtetutshmërinë e normës. Vetëm në këtë mënyrë realizohet administrimi i mirë i drejtësisë, transparenca e procesit për palët, si dhe mbrojtja e kushtetutshmërisë.

17. Një synim tjetër që ka kontrolli kushtetues i iniciuar nga gjykatat e zakonshme është edhe garantimi i sigurisë juridike dhe i njëtrajtshmërisë së zbatimit nga gjykatat e zakonshme, të cilat mund të kenë qasje të ndryshme lidhur me kushtetutshmërinë e normës. Për këtë arsye është e rëndësishme që të respektohet kontrolli kushtetues nëpërmjet referimit të çështjeve nga gjykatat e zakonshme tek Gjykata Kushtetuese Si ruajtja e autoritetit të ligjvënës, ashtu edhe garantimi i sigurisë juridike kanë mjaft rëndësi për funksionimin e shtetit që bazohet në parimin e ndarjes e balancimit të pushteteve dhe të shtetit të së drejtës. Këto qëllime të mbrojtura nga Kushtetuta nëpërmjet kontrollit kushtetues nga gjykatat e zakonshme nuk mund të anashkalohen nga një zbatim sipërfaqësor i së drejtës, që sjell si pasojë cenimin e të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Këto qëndrime i mbështesim edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Federale Kushtetuese (GJFK) gjermane lidhur me rolin dhe funksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për vënien në lëvizje të GJFK nëpërmjet kontrollit incidental, në zbatim të nenit 101/1 të Ligjit Themelor gjerman (*shih vendimet nr. 1BvR 2142/11; BVerfGE 29, 45 të GJFK-së*).

18. Për sa më lart, jemi të qëndrimit se shumica duhej të kishte pranuar edhe kërkesën e kërkuar për shfuqizimin e nenit 289/3 të Kodit Doganor si antikushtetues, duke i hapur mundësinë kërkuar t'i drejtohet gjykatës administrative për zgjidhjen në themel të konfliktit me Drejtorinë e Doganave. Kjo zgjidhje është në përputhje të plotë me parimin e procesit të rregullt ligjor, duke e bërë ankimin kushtetues para kësaj Gjykate një mjet juridik efektiv, në përputhje me nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Gani Dizdari, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Jemi kundër vendimit të shumicës me të cilin është vendosur të pranohet pjesërisht kërkesa e kërkuar, Komandës së Forcave të Armatosura, Reparti Ushtarak 3001, Rinas, pasi vlerësojmë se Gjykata duhet të kishte vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë për arsye se:

2. Kërkuarja ka pretenduar se nëpërmjet vendimeve gjyqësore objekt kërkesë i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, si dhe ka kërkuar që nëpërmjet një gjykimi abstrakt të shfuqizohet si antikushtetues neni 289/3 i Kodit Doganor.

3. Lidhur me kërkesën e parë të kërkuar bashkohemi me shumicën, pasi kërkuarja nuk mundi të sjellë argumente për të provuar pretendimin e saj se vendimet e gjykatave janë rezultat i një procesi të parregullt në kuptim të gjyqësorit kushtetues.

4. Për sa i përket kërimit të dytë, jemi të mendimit se kërkuar nuk duhet të ishte legjitimuar, pasi ai nuk përfshihet në asnjë prej subjekteve të përcaktuara në dispozitën e nenit 134 të Kushtetutës së Republikës Shqipërisë, sipas së cilës: “1. Gjykata Kushtetuese vëhet në lëvizje vetëm me kërkesë të: a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) jo më pak se një të pestës së deputetëve; ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute; dh) Avokatit të Popullit; e) organeve të qeverisjes vendore; ë) organeve të bashkësive fetare; f) partive politike dhe organizatave të tjera; g) individëve”.

5. Siç del qartë nga përmbajtja e kësaj dispozite, kërkuarja nuk bën pjesë në asnjë prej këtyre subjekteve që ta legjitimojë atë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ndryshe nga mendimi i shumicës, jemi të mendimit se nuk mund të barazohen me individët organet shtetërore apo ndërmarrjet shtetërore në vartësi të ekzekutivit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht për rastet e përcaktuara në nenin 131/a, pasi edhe nëse do të pranohet që këta organizma të ekzekutivit, siç është rasti i kërkuar, do të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas përcaktimeve të nenit 131/f të Kushtetutës, pra si individë, kurrësi ata gjatë një gjykimi të tillë nuk mund të legjitimohen të kërkojnë papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, pasi kjo do të zgjeronte në mënyrë të padrejtë dhe jashtë parashikimeve të Kushtetutës juridiksionin e kësaj Gjykate, duke i



dhënë të drejtë çdo individ që të vërë në lëvizje këtë Gjykatë, me pretendimin se ligji i zbatueshëm vjen ndesh me Kushtetutën. Në mënyrë të shprehur Kushtetuta këtë të drejtë ua ka dhënë subjekteve të pakushtëzuara të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të nenit 134.

6. Për arsyet e mësipërme jemi të mendimit se kërkesa e kërkuës duhet të ishte rrëzuar.

Anëtarë: Fatos Lulo, Besnik Imeraj

KËRKESË

Nr. 2232, datë 21.4.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit, Himarë”, i ndryshuar.

Subjekti kërkuës i këtij objekti është Bashkia Himarë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 20,565,797 (njëzet milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONËSIMIT QË NUK JANE SHPRONËSUAR NGA V.K.M -JA NR.999 DATE 9.12.2015
PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHËTITORES KRYESORE ANES DETIT, HIMARË"

Nr	Mbiemer	Emer	Lloji i pasurisë	Nr. Hipotekore/Pasurie	Zone Kadastrale	Sip. objektit që shpronësohet	Cmimi i objektit për njësi sipas titullit të shpronësisë	Vlera e objektit për shpronësimet në Leke	Cmimi i tokës së objektit për njësi sipas VKM.nr.514	Vlera e tokës për shpronësimet në Leke	Vlera totale për shpronësimet =vlerë e objektit - vlerë e tokës në proporcion me sip.	Vendodhje
1	Gjicali	Fotaq	Objekt-banese-KATI PARE	244	1952	176 m ²	42561 leke/m ²	7490736	4350 leke/m ²	255200	7235536	Spile,Himare
2	Gjicali	Fotaq	Objekt-banese-KATI DYTE	244	1952	176 m ²	42561 leke/m ²	7490736	4350 leke/m ²	255200	7235536	Spile,Himare

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONËSIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHËTITORES KRYESORE ANES DETIT, SPILE"

Nr	Mbiemer	Atesia	Emer	Lloji i pasurisë	Nr. Hipotekore/Pasurie	Zone Kadastrale	Sip. objektit që shpronësohet	Vlera e objektit për shpronësimet në Leke	Vlera totale për shpronësimet =vlerë e ndertesës	Vendodhje
1	Veizi		Veniamin + Agron	Banese	205	1952	99,75 m ²	61100 Lek/m ²	6094.725	Himare, Spile

SHUMA: 6.094.725

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë